


2- Informacionit

Dr. Juidela
shpallje
20-02-2025
Aut

Nr. 465 Prot.

Datë 26.02.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM SARANDË
Nr. 00241 Regj Them. Sarandë me date 17.02.2025.

SHPLLJE - VENDIMI
NE GJYKATË DHE NË BASHKINE DELVINE

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë me vendimin e saj penal nr.23-2022-1415, date 29.09.2022 ka:

VENDOSUR

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit Klodian Astrit Pashako, për kryerjen e veprës penale "Vrasja me dashje" parashikuar nga nenet 76 në lidhje me nenin 22 të Kodit Penal, dhe dënimin e tij me 10 (dhjetë) vjet burgim
 2. Deklarimin fajtor të të pandehurit Klodian Astrit Pashako, për kryerjen e veprës penale "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive, parashikuar nga neni 280 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burgim.
 3. Në zbatim të nenit 55 të K.Penal, dënimin përfundimtar të të pandehurit Klodian Astrit Pashako me 10 (dhjetë) vjet burgim.
 4. Në aplikim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, të pandehurit Klodian Astrit Pashako i zbritet 1/3 e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 6 (gjashtë) vjet e 8 (tetë) muaj burgim.
 5. Ekzekutimi i vendimit të fillojë nga data e arrestimit të tij 19.10.2016, dhe të vuhet në një burg të sigurisë së zakonshme.
 6. Në aplikim të nenit 190 të K.Pr.Penale, provat materiale të sekuestruara me procesverbalin e datës 25.08.2013 t'i kthehen personit që i takojnë pasi vendimi të marrë formë të prerë.
 7. Shpenzimet procedurale gjatë hetimeve paraprake dhe ato gjyqësore i ngarkohen të pandehurit.
 8. Ngarkohet Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, me ekzekutimin e këtij vendimi.
 9. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.
- U shpall sot në Sarandë, më datë 29.09.2022.

Duke qene se per viktimen Ziso Xhafer Zhuli, banues në Lagjen Lejla Malo Delvine, ka ardhur njoftimi " I panjohur", ne baze te nenit 140/4, 141 te K.Pr.Penale, nxirret kjo shpallje ne Gjykate dhe ne Bashkine Delvine, e cila zë vendin e njoftimit për vendimin penal nr.23-2022-1415, date 29.09.2022.

